



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P-076
Prishtinë, më 8 tetor 2016, ora 0:20

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 8 TETOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës të caktuar me vendim të seancës së mëparshme, më 7 tetor 2016.

Kuvendi i zhvilloi punimet me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për “Trepçën”

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe komisionet e tjera parlamentare e kanë rishqyrtuar Projektligjin për “Trepçën” dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Në këtë projektligj ishin propozuar 21 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe nga nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1A, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12,13, 14A, 15, 16, 19, 20 dhe 21.

Kuvendi nuk i miratoi këto amendamente: 1B, 2, 3, 7, 14B, 17 dhe 18.

Pastaj, kryetari e hodhi në votimi tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	79,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	14.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash:

V E N D O S I

Miratohet Projektligji nr. 05/L-120 për “Trepçën”.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 01:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale